



Informacione për vaksinimin “Covid-19” në vjeshtë 2022

Më të rëndësishmet shkurtimisht

- Në momentin e tanishëm të pandemisë, pothuajse të gjithë personat në Zvicër ose janë vaksinuar dhe/ose kanë kaluar “Covid-19”. Sistemi juaj i imunitetit është përballur përkatësisht me virusin korona. Variantet e virusit që qarkullojnë aktualisht shkaktojnë përveç kësaj ecure më të butë të sëmundjes sesa variantet e mëparshme. Kështu që rezulton një pikënisje e re për vjeshtën e vitit 2022 dhe nga kjo një këshillim i përshtatur vaksinimi.
- Personat që janë veçanërisht të rrezikuar për ecuri të rënda të “Covid-19” mund të përmirësojnë, të paktën përkohësisht, mbrojtjen e tyre kundër sëmundjeve të rënda me vaksinimin përtëritës në vjeshtën e vitit 2022. Prandaj vaksinimi përtëritës këshillohet fort për të gjithë personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë.
→ [Fletëshpjegim për persona të rrezikuar në mënyrë të veçantë](#)
- Të gjithë personave të tjerë nga mosha 16 vjeç, vaksinimi përtëritës në vjeshtën e vitit 2022 iu ofron një mbrojtje të ulët dhe afatshkurtër kundër infeksioneve me sëmundje të lehtë. Rreziku i një sëmundjeje të rëndë për personat e vaksinuar në këtë grup është shumë i ulët falë mbrojtjes tanimë ekzistuese.

Kujt i këshillohet një vaksinim përtëritës në vjeshtën e vitit 2022?

Vaksinimi përtëritës në vjeshtën e vitit 2022 iu këshillohet fort të gjithë personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë:

- Personave nga mosha 65 vjeç
- Personave nga mosha 16 vjeç me një sëmundje kronike
- Personave nga mosha 16 vjeç me trisomi 21
- Shtatzënave

Të gjithë personat e tjerë nga mosha 16 vjeç mund të vaksinohen po ashtu në vjeshtën e vitit 2022. Këshillimi është në varësi të grupit të popullsisë me fortësi të ndryshme.

Grupi i popullsisë	Fortësia e këshillimit
Personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë	+++ i fortë
Personel shëndetësor, personat e përkujdesjes të personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë	++ mesatar
Të gjithë personat e tjerë 16-64 vjeç	(+) i ulët

Vaksinimi iu këshillohet po ashtu të gjithë personave që nuk janë vaksinuar ende kundër “Covid-19”.

Si përfitojnë grupet e ndryshme të popullsisë nga vaksinimi përtëritës në vjeshtën e vitit 2022?

- **Personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë**
Ky grup ka rrezikun më të lartë për sëmundje të rënda dhe tek ky ulet më së pari mbrojtja nga vaksinimet e mëparshme. Vaksinimi i mëtejshëm përtëritës përmirëson mbrojtjen kundër sëmundjeve të rënda të paktën për disa muaj. Edhe persona me një sistem imuniteti të dobësuar shumë (për shkak të një sëmundjeje ose terapie) dhe persona nga mosha 80 vjeç që kanë marrë tanimë një vaksinim të dytë përtëritës mund të përmirësojnë kështu përsëri mbrojtjen e tyre kundër një sëmundjeje të rëndë.
- **Personel shëndetësor, personat e përkujdesjes**
Rreziku i një sëmundjeje të rëndë për personat e vaksinuar në këtë grup është shumë i ulët falë mbrojtjes tanimë ekzistuese. Vaksinimi i mëtejshëm përtëritës ofron një mbrojtje të ulët dhe afatshkurtër kundër infeksioneve me sëmundje të lehtë: Bartja e virusit mbi persona të tjerë pothuajse nuk mund të pengohet.

Vaksinimi përtëritës iu këshillohet të gjithë personave të këtij grupi, të cilët duan të zvogëlojnë disi rrezikun e tyre të infektimit, me qëllim që të ruajnë kujdesin e personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë dhe për të siguruar kujdesin shëndetësor.

- **Të gjithë personave të tjerë nga mosha 16 deri në 64 vjeç**
Rreziku i një sëmundjeje të rëndë për personat e vaksinuar në këtë grup është shumë i ulët falë mbrojtjes tanimë ekzistuese. Vaksinimi i mëtejshëm përtëritës ofron një mbrojtje të ulët dhe afatshkurtër kundër infeksioneve me sëmundje të lehtë: Bartja e virusit mbi persona të tjerë pothuajse nuk mund të pengohet. Vaksinimi përtëritës iu bëhet i mundur atyre personave, të cilët duan të zvogëlojnë disi rrezikun e tyre të infektimit për arsye private dhe/ose profesionale.

Për persona nën 16 vjeç nuk këshillohet asnjë vaksinim përtëritës në vjeshtën e vitit 2022, pasi rreziku për një sëmundje të rëndë me “Covid-19” tek të rinjtë dhe fëmijët është shumë i ulët. Shumica dërrmuese e fëmijëve nga mosha 5 vjeç dhe e të rinjve kanë tanimë antitropa kundër virusit korona për shkak të një infeksioni ose vaksinimi të mëparshëm.

Kur duhet bërë vaksinimi përtëritës?

Vaksinimi përtëritës në vjeshtën e vitit 2022 mund të bëhet nga 4 muaj pas vaksinimit të fundit kundër “Covid-19” ose nga 4 muaj pas një infeksioni të njohur me virusin korona.

Kjo vlen edhe për personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë të cilët kanë marrë tanimë një vaksinim të dytë përtëritës.

Vaksinime të tjera me lëndë të tjera të çaktivizuara të vaksinimit (si p.sh. vaksina kundër gripit) mund të bëhen para, në të njëjtën kohë me një vaksinim “Covid-19” ose pas kësaj.

Ju lutemi, vini re: A keni temperaturë të lartë? A jeni i sëmurë dhe nuk ndiheni mirë? Atëherë shtyjeni terminin për vaksinim.

Çfarë vlen për personat nga mosha 16 vjeç të cilët nuk kanë marrë ende deri tani një vaksinë kundër “Covid-19”?

Në këtë pikë të pandemisë, në Zvicër, pothuajse të gjithë personat e pa vaksinuar janë infektuar të paktën një herë me virusin korona. Sistemi juaj i imunitetit është përballur kështu tanimë me virusin. Për këtë arsye, iu këshillohet personave, të cilët nuk bëjnë pjesë në personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë, vetëm një dozë vaksinimi.

Kështu do të përmirësohet mbrojtja kundër një sëmundjeje të rëndë. Alternativë janë po ashtu dy doza të vaksinës me një distancë prej 4 javësh.

Për personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë: shih fletëshpjegimin e veçantë

→ [Fletëshpjegim për persona të rrezikuar në mënyrë të veçantë.](#)

Cila lëndë vaksinimi këshillohet?

Për vaksinimin në vjeshtë ne këshillojmë me përparësi vaksinimin me një lëndë mRNA vaksinimi (bivalente) të përshtatur me variantin ose me vaksinën e proteinës "Novavax" kur këto janë të disponueshme. Gjatë kësaj nuk ka rëndësi se me cilën lëndë vaksinimi u bënë vaksinat e deritanishme.

Në rastin e lëndëve mRNA për vaksinim (Pfizer/BioNTech ose Moderna) janë të përshtatshme për vaksinimin përtëritës në vjeshtën e vitit 2022 si lëndët e deritanishme (monovalente) të vaksinimit, ashtu edhe një lëndë e vaksinimit (bivalente) e përshtatur me variantin. Të dhënat aktuale tregojnë se lëndët monovalente mRNA të vaksinimit vazhdojnë të ofrojnë edhe më tej mbrojtje të mirë kundër ecurive të rënda me shtrime në spital edhe me variantet e reja të Omikron.

E rëndësishme: Shtatzëna dhe persona që ushqejnë me gji do të duhej të linin të vaksinoheshin me një lëndë mRNA vaksinimi (jo me lëndën proteinë të vaksinimit nga Novavax).

Për cilët persona nuk janë të përshtatshme lëndë të caktuara vaksinimi?

Ne **nuk** iu këshillojmë vaksinimin kundër "COVID-19" me një lëndë mRNA vaksinimi personave të mëposhtëm:

- Personave me një alergji të rëndë të vërtetuar ndaj një komponenti të lëndës së vaksinimit, p.sh. glikolit të polietilenit (PEG) ose trometaminës (TRIS).

Personave të mëposhtëm ne **nuk** iu këshillojmë vaksinimin kundër "Covid-19" me lëndën për vaksinim nga proteina të Novavax:

- Personave me një alergji të rëndë të vërtetuar ndaj një komponenti të lëndës së vaksinimit, para së gjithash polisrobat 80, saponine, Matrix-M.

Në këto raste, ju lutemi, lini të këshilloheni nga një alergologe, një alergolog. Informacione të mëtejshme ju gjeni në faqen e internetit: www.foph-coronavirus.ch/vaccination.

Është i sigurt vaksinimi?

Vaksinimi kundër "Covid-19" është i sigurt. Çdo lëndë për vaksinim, në Zvicër, ka nevojë për një lejim. Për këtë gjë duhet që ajo të përmbushë kërkesa të larta për sa i përket sigurisë, efektivitetit dhe cilësisë. Dobia e një vaccine duhet që t'i tejkalojë qartësisht rreziqet. Vetëm atëherë këshillohet kjo vaksinë në Zvicër. Specialistët vazhdojnë të monitorojnë sigurinë dhe efektivitetin e lëndëve për vaksinim.

Cilat efekte anësore janë të mundshme?

Mund të ketë efekte anësore në rast të çdo vaksinimi. Në shumicën e rasteve ato janë të dobëta deri në moderate dhe mbarojnë shpejt.

Këto efekte anësore shfaqen shpesh pas vaksinimeve:

- Vendi i injektimit në krah, ku ju vaksinoheni dhemb, është i skuqur ose është i ënjtur.
- Lodhje
- Dhimbje koke
- Dhimbje muskujsh dhe gjymtyrësh
- Simptoma të përgjithshme si të dridhura, ndjesi të temperaturës ose temperaturë të lehtë
- Të përziera
- Nyje limfatike të fryra ose të dhimbshme në sqetull
- Skuqje të lëkurës dhe kruajtje

Këto reaksione tregojnë se trupi krijon mbrojtje kundër sëmundjes. Efektet anësore, si rregull, zhduken pas disa ditësh. Keni ju pas një jave ende efekte anësore? Po bëhen ato më keq? Apo jeni i shqetësuar?

Atëherë bisedoni me mjeken tuaj ose me mjekun tuaj.

Shumë rrallë ka efekte anësore të rënda. Kështu tek persona të veçantë ndodh një reaksion alergjik i rëndë menjëherë pas vaksinimit. Për shembull në një ënjtje, skuqje, kruajtje ose vështirësi frymëmarrjeje.

Në raste shumë të rralla u vunë re brenda 14 ditëve pas vaksinimit infeksione të muskullit të zemrës ose perikardit që zakonisht ishin të lehta dhe mund të trajtoheshin mirë. Simptoma tipike të një infeksioni të muskullit të zemrës janë dhimbje gjoksi, vështirësi në frymëmarrje dhe aritmi e fortë, në pjesën më të madhe të kohës brenda 2 javësh pas vaksinimit.

Në rast të simptomave të tilla drejtoju menjëherë mjekes suaj ose mjekut tuaj.

Informacione të mëtejshme

Kostot: Një vaksinim i këshilluar kundër "Covid-19" është pa pagesë për ju.

Mundësi të vaksinimit: Informohuni në faqen e uebit ose në linjën e informimit të kantonit tuaj (www.foph-coronavirus.ch/cantons), se ku mund të lini ju të vaksinoheni.

Informacione të mëtejshme mbi vaksinimin kundër "COVID-19" ju mund të gjeni në faqen e internetit të FOPH: www.foph-coronavirus.ch/vaccination ose pyesni mjeken ose mjekun tuaj. Ose në farmacinë tuaj.

Linke:

- [How does the COVID-19 vaccination work? | FOPH \(foph-coronavirus.ch\)](#)
- [Frequently Asked Questions \(FAQs\) \(admin.ch\)](#)

